



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0021909/-2/ dt. 28.04.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenet 8, 10 dhe 27 të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0021909/26, dt. 21.04.2026, të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Vlerësimin e Aplikacioneve në bazë të Thirrjes Publike për Trajnim dhe Praktikë në Punë për Personat me Aftësi të Kufizuara)

- 1. Formohet** Komisioni për Vlerësimin e aplikacioneve në bazë të Thirrjes Publike për Trajnim dhe Praktikë në Punë për Personat me Aftësi të Kufizuara, të miratuar në bazë të Vendimit Nr. 01-113/04-0017212-2/26, dt. 03.04.2026, në këtë përbërje:
 - 1.1** Bedri Murati – kryesues (DEZHTIE);
 - 1.2** Arjeta Hoti Musa – anëtare (DKRS);
 - 1.3** Ibadete Syla Voca – anëtare (DMM).
- 2.** Komisioni është përgjegjës që të bëjë vlerësimin e të gjitha aplikacioneve/kërkesave që janë dorëzuar për praktikë në punë me pagesë për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me kriteret e Thirrjes Publike të datës 03.04.2026, e miratuar me Vendimin Nr. 01-113/04-0017212-2/26, dt. 03.04.2026, Rregulloren Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe dispozitat tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 3.** Komisioni është përgjegjës që të bëjë vlerësimin e aplikacioneve si nga aspekti procedural, po ashtu dhe ai përmbajtjesor në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga momenti i mbylljes së Thirrjes Publike.
- 4.** Gjatë fazës së vlerësimit Komisioni obligohet që të mbajë Procesverbal nga momenti i hapjes së procesit e deri në marrjen e Vendimit, duke përfshirë dhe pikët me rastin e vlerësimit.
- 5.** Pas përfundimit të vlerësimit Komisioni sjell Vendim, i cili duhet të përfshijë kërkesat e miratuara dhe ato të refuzuara, ku ky Vendim duhet të publikohet në ueb faqen e Komunës.



6. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: kriteret e Thirrjes Publike, Rregulloren Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
7. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundimin e fazës së vlerësimit.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Faton PEÇI

Shtojcë:

- 1x1 Propozim – Vendimi i DEZHTIE-së, Nr. 01-020/04-0021909/26, dt. 21.04.2026;
- 1x1 Thirrja Publike e DEZHTIE-së.

Ti dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit